

 FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA
BASKETBALL FEDERATION OF KOSOVO
Nr. 144 Dt. 19.02.2020
PRISHTINË • PRISTINA • PRISTINA

Federata e Basketbollit të Kosovës

**Raporti i pavarur i auditorit dhe pasqyrat financiare për vitin që perfundon më
31 Dhjetor 2019**

Përmbajtja

RAPORTI I AUDITORIT TE PAVARUR

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	5
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	6
PASQYRA E BILANCIT TË FONDEVE	7
PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË	8
1. Hyrje	9
2. Politikat e kontabilitetit	10
3. Llogaritë e Arkëtueshme	11
4. Paraja dhe ekuivalentët e saj.....	11
5. Llogaritë e Pagueshme.....	11
6. Pagat dhe tatimet e pagueshme.....	12
7. Të hyrat nga aktivitetet	12
8. Të hyrat nga aktivitetet	12
9. Shpenzimet e Pagave	12
10. Shpenzime operative.....	13
1. Detyrimet kontingjente dhe zotimet	14
2. Ngjarjet pasuese.....	14

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Menaxhmentin e "Federata e Basketbollit të Kosovës"

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare "Federata e Basketbollit të Kosovës" te cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2019, pasqyra e të ardhurave, pasqyra e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyra e rrjedh-ës së parasë për vitin që përfundoi në atë datë, dhe shënimet e pasqyrave financiare, përfshirë një përmbledh-je të politikave më të rëndësishme kontabël.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të organiatës me 31 dhjetor 2019, të performancës financiare dhe rrjedhës së parasë për vitin që përfundoi në atë datë dhe janë në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinionin

Auditimin e kemi kry në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tutje në seksionin *Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare të këtij raporti*.

Jemi të pavarur nga organizata në pajtueshmëri me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionist të BorditNdërkobëtar të Standardeve të Etikës (Kodi i IESBA) së bashku me kërkesat që janë relevante gjatë auditimit të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona tjera etike në pajtueshmëri me këto kërkesa dhe Kodin e IESBA.

Besojmë se evidanca e përftuar e auditimit është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazë të arsyeshme për opinion.

Theksim i çështjes

Duhet të theksohet se subjekti në fjalë ka ndërruar politikat kontabel duke kaluar nga parimi i keshit për regjistrimet në kontabilitet tek parimi aktual i kontabilitetit, gjë e cila ka prodhuar përfshirjen e shpenzimeve të vitit 2018 në pasqyrat e vitit 2019 në shumën 95,476 euro,

Subjekti në fjalë nuk ka bërë përlogaritjen dhe ndalesën e obligimeve ligjore të tatimeve dhe kontributeve për medijtje dhe kompenzime tjera në shumë prej 39,565, e cila mund të prodhon shpenzime shtesë, por marë në tërsi nuk është materiale.

Çështjet Kryesore të Auditimit

Çështje Kryesore të Auditimit janë ato çështje që, në gjykimin tonë profesional, kanë qënë më të rëndësishmet në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje kanë qënë adresuar në kontekstin e auditimit të pasqyrave financiare në tërësi dhe të formimit të opinionit tonë në lidhje me to, kështu që për këto çështje, ne nuk japim opinion të veçantë.

Vijimësia

Pasqyrat financiare, janë përgadit mbi bazën e vijimësisë, drejtimi nuk ka për synim likuidimin as ndërprerjen e veprimtarisë së vetë për 12 muajt e ardhshëm.

Mirepo auditori shprehë rezervën e vet lidhur me vijimësinë për shkak të detyrimeve të mëdha në shumë prej 391,791, gjegjësisht të pa mbuluara 266,220 Euro, për të cilat menaxhmenti ka përgaditur planin e sanimit.

Informacione të tjera të ndryshme nga Pasqyrat Financiare

Informacione tjera, financiare ose jo financiare që ndryshojnë nga pasqyrat financiare të audituara dhe raporti i audituesit mbi këto pasqyra, të përfshira në raportin vjetor të entitetit dhe kanë mospërputhje materiale me PF ose me njohjen e siguruar nga audituesi gjatë auditimit, ku çdonjëra prej tyre mund të dëmtojë besueshmërinë e PF dhe të raportit të audituesit mbi këto pasqyra, nuk janë identifikuar.

Përgjegjësitë e drejtimit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në pajtueshmëri me SNRF dhe për kontrollin e tilla të cilat drejtimi mendon se janë të domosdoshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit.

A.F.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së organizatës të vijojë sipas hipotezës së vijimësisë, duke shpalosur, nëse është e zbatueshme, çështjet lidhur me hipotezën e vijimësisë dhe duke përdorur bazën e kontabilitetit bazuar në vijimësi përveç nëse drejtimi ka për qëllim të likuidojë ose të ndërpresë aktivitetet e kompanisë, ose nuk ka ndonjë alternativë tjetër përveç të veprorë në këtë mënyrë.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të organizatës.

Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të përftojme siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të japim një raport të auditorit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garanci se auditimi i kryer sipas SNA gjithmonë do të zbulojë anomali materiale në rast se ato ekzistojnë. Anomalitë mund të paraqiten nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen që janë materiale nëse, individualisht ose të grumbulluara, ato mund të ndikojnë në mënyrë të arsyeshme në vendimin që marrin përdoruesit bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në pajtueshmëri me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional përgjatë tërë auditimit.

Ne gjithashtu jemi përgjegjës të:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit si përgjigje ndaj këtyre rreziqeve dhe përftojme evidenca të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të na ofruar bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të anomalive materiale për shkak të mashtrimit është më i lartë se ai i shkaktuar nga gabimet, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshjet e fshehta, falsifikimin, lënjen anash me qëllim, keqinterpretimin ose anashkalimin e kontrolleve.
- Përftojme njohuri mbi kontrollet e brendshme që janë relevante për auditimin në mënyrë që të projektojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për ato rrethana, por jo me qëllim të japim një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të organizatës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësim-eve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse nga drejtimi.
- Përfundojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të hipotezës së vijimësisë nga ana e drejtimit dhe bazuar nga evidenca e përftuar e auditimit, nëse ekziston ndonjë pasiguri materiale lidhur me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshim domethënës mbi aftësinë e organizatës për të vijuar ekzistencën. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit në shpalosjen përkatëse të pasqyrave financiare ose, nëse një shpalosje e tillë është e pamjaftueshme, ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të përfuara deri në datën e raportit të auditorit. Mirëpo, ngjarjet dhe kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që organizata të mos vijojë aktivitetet e saj.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjen nëse pasqyrat financiare përfaqësojnë transaksionet dhe ngjarjet përkatëse në mënyrë që të arrihet paraqitja e drejtë.

Kemi komunikuar me personat e ngarkuar me qeverisjen, në mes tjerash edhe lidhur me fushëveprimin e planifikuar, kohën e auditimit dhe gjetjet domethënës të auditimit, përfshirë çfardo mangësi domethënës në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

Audit Office
Xhemail Sylja
Rr: Ulpiana D1/7 nr.8
10000 Prishtine
Republika e Kosoves
Tel: +383 44 156 921
Email: xhemailsyla@gmail.com
Data: 17.02.2020



PRISHTINË

A.F.

FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS - FBK

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

Me 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018

Të gjitha shumat në Euro

Me 31 dhjetor		2019	2018
Asetet	<i>Shënime</i>		
Asetet jo-qarkulluese			
Pajisjet dhe makinat		-	-
Total asetet jo-qarkulluese		-	-
Asetet qarkulluese			
Llogaritë e arketushme	3	91,039	-
Parapagime		948	
Paraja	4	33,585	44,127
Total asetet qarkulluese		125,571	44,127
Total Asetet		125,571	44,127
Detyrimet dhe fondi			
Fondi			
Bilanci i fondeve me 01 Janar		44,127	942
Teprica / (Deficiti) nga pasqyrat e të ardhurave		(310,347)	43,185
Totali i fondeve		(266,220)	44,127
Detyrimet afatshkurta			
Llogaritë e pagueshme	5	386,635	
Pagat dhe tatimet e pagueshme	6	5,156	
Total i detyrimeve afatshkurta		391,791	
Totali i detyrimeve dhe bilanci i fondit		125,571	44,127

Aprovuar nga:

Arben Fetahu, Kryetar



Shënimet e bashkëngjitura në faqet 7 deri 12 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

A.F.

FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS - FBK
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE
Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018
Të gjitha shumat në Euro

	<i>Shënimet</i>	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2019	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2018
Të hyrat			
Të hyrat nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve		443,270	269,925
Të hyrat nga FIBA		75,163	149,933
Të hyrat nga donatorët	7	93,168	119,963
Të hyrat nga aktivitetet	8	323,162	182,064
Totali i të hyrave		934,763	721,885
Shpenzimet			
Shpenzime për Paga të Stafit, Trajnerëve, Referëve dhe të tjera	9	(189,799)	(125,618)
Shpenzime të tjera	10	(1,055,311)	(553,082)
Totali i shpenzimeve		(1,245,110)	(678,700)
Teprica (humbja)		(310,347)	43,185

Shënimet e bashkëngjitura në faqet 7 deri 12 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

AF.

FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS - FBK**PASQYRA E BILANCIT TË FONDEVE**

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018

Të gjitha shumat në Euro

	Bilanci I fondeve	Gjithsej
Më 31 dhjetor 2017	942	942
Fitimi / (humbja) i/e vitit	43,185	43,185
Më 31 dhjetor 2018	44,127	44,127
Fitimi / (humbja) i/e vitit	(310,347)	(310,347)
Më 31 dhjetor 2019	(266,220)	(266,220)

Shënimet e bashkëngjitura në faqet 7 deri 12 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

A.F.

FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS - FBK
PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018

Të gjitha shumat në Euro

	<u>2019</u>	<u>2018</u>
I. Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi neto i periudhës	(310,347)	43,185
<i>Korigjuar për transaksionet jo monetare:</i>		
Shpenzimet e zhvlerësimit	-	-
Të ardhurat kapitale	-	-
	<u>(310,347)</u>	<u>43,185</u>
Lëvizjet në kapitalin qarkullues		
(Rritja)/Zvogëlimi në të arkëtueshme	(91,039)	
(Rritja)/Zvogëlimi në avanset e dhëna	(948)	
Rritja/(Zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme dhe të tjera	386,635	(5,951)
Rritja/(Zvogëlimi) në tatime dhe paga të pagueshme	5,156	
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative (I)	<u>(10,542)</u>	<u>37,235</u>
II. Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese		
Blerja e pasurive joqarkulluese		
Shitja e pasurive joqarkulluese		
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese (II)	<u>-</u>	<u>-</u>
III. Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese		
Rritja/(Zvogëlimi) i kredive bankare		
Rritja/(Zvogëlimi) huamarrjeve financuese		
Tërheqjet e pronarit(Dividenda)		
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese (III)	<u>-</u>	<u>-</u>
IV. Rritja neto në para dhe ekuivalente (I + II + III)	<u>(10,542)</u>	<u>37,235</u>
V. Paraja në fillim të vitit/periudhës	<u>44,127</u>	<u>6,893</u>
VI. Paraja në fillim të vitit/periudhës (IV + V)	<u><u>33,585</u></u>	<u><u>44,127</u></u>

Shënimet e bashkëngjitura në faqet 7 deri 12 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

A.F.

FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS – FBK

Shënimet e Pasqyrave Financiare

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018

Të gjitha shumat në Euro

1. Hyrje

Federata e Basketbollit e Kosovës është asociacion vullnetar i pavarur i klubeve dhe shoqatave të themeluara nga qytetarët, me qëllim të interesave të veçanta dhe të përbashkëta në lëmin e sportit të basketbollit.

Federata e Basketbollit e Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Federata) është institucioni më i lartë i sportit të basketbollit në Kosovë për meshkuj dhe femra, që për veprimtari themelore e ka sportin e basketbollit, e organizuar në pajtueshmëri me dispozitat e Ligjit për Sport e Kosovës.

Federata është subjekt juridik dhe vepron në pajtim me Statutin, Statutin dhe Rregulloret e FIBA-s, Ligjin për Sportin e Kosovës dhe Ligjin mbi organizatat jo fitimprurëse.

Federata, si organizatë jo fitimprurëse është e regjistruar në organin përgjegjës dhe e licencuar në Ministrinë për Kulturë, Rini dhe Sport të Kosovës (Departamenti i Sportit).

Qëllimet e Federatës janë:

- Masovizimi, zhvillimi cilësor dhe organizimi i basketbollit në Kosovë.
- Sigurimi dhe realizimi i të gjitha kushteve për veprimtarinë e seleksioneve të Federatës.
- Organizimi dhe avancimi profesional i lojtarëve, trajnerëve, gjyqtarëve dhe vëzhguesve të basketbollit.
- Ndihma organizatave të tjera në promovimin e basketbollit në të gjitha fushëveprimet e sportit të basketbollit, në përputhje me aktet normative.
- Përcaktimi i sistemit të garave për të gjitha kategoritë në nivel të Federatës.
- Pjesëmarrja në manifestime dhe gara ndërkombëtare.
- Mbështetja e zhvillimit të basketbollit në vise të pazhvilluara të Kosovës.
- Organizimi i të gjitha garave në nivel të Kosovës, siç janë: Ligat, Kupa dhe turnetë.
- Organizimi i aktiviteteve profesionale vendore dhe ndërkombëtare.
- Organizimi i kampeve, seminareve, publikimeve profesionale etj.
- Sigurimi i bazës materiale për sportin e basketbollit nëpërmjet marketingut, aktiviteteve ekonomike me qëllim të përmbushjes të kërkesave për veprimtarinë e Federatës
- Përcaktimi i parimeve themelore mbi definimin e statusit të gjithë subjekteve në kuadër të Federatës.
- Pjesëmarrja në punën e KOK-ut dhe asociacioneve të tjera sportive.
- Veprimi kundër përdorimit të dopingut, në përputhje me vendimet e KOK-ut dhe FIBA-s.
- Pjesëmarrja në punën e organizatave të tjera sportive ndërkombëtare, të cilat janë të lidhura me sportin e basketbollit.

Anëtarët e Federatës janë: Klubet e basketbollit (publik edhe private), Shoqata e trajnerëve, Shoqata e gjyqtarëve (organizata profesionale të Federatës), dhe të gjitha klubet dhe shoqatat e tjera të cilat pranohen dhe licencohen në Federatë.

Çdo anëtar i Federatës duhet ta paguajë anëtarësinë vjetore, të cilën e cakton Kuvendi

Organet e Federatës janë:

- Kuvendi
- Bordi
- Kryetari
- Këshilli Mbikëqyrës

AF

FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS – FBK

Shënimet e Pasqyrave Financiare

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018

Të gjitha shumat në Euro

2. Politikat e kontabilitetit

Në vijim janë politikat themelore të kontabilitetit të adaptuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare:

2.1 Bazat e përgatitjes

Për qëllime të raportimit financiar për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2019, FBK përdor dy metodat e raportimit financiar në formë të kombinuar që do të thotë sipas bazës akruale dhe sipas bazës së parasë së gatshme për arsye të raportimit, pranimit dhe shfrytëzimit të fondeve të pranuar nga donatorët. Pavarësisht pëdorimit të metodave të kombinuara për raportim financiar pjesa më e madhe e transaksioneve financiare janë të regjistruara në bazë së parasë së gatshme në sistemin kontabël.

2.2 Transaksionet në valuta të huaja

Transaksionet në valuta të huaja janë të shndërruara në vlerën monetare raportuese duke përdorur shkallën aktuale të këmbimit të transaksionit. Fitimi dhe humbja si rezultat i transaksioneve nga shëndrimi në normat e këmbimit të fund- vitit të mjeteve monetare dhe detyrimeve në valutat e huaja janë të njohura në pasqyrën e të ardhurave.

2.3 Prona, impijantet dhe paisjet

Meqë Federata nuk posedon me pasuri të paprekshme, ajo në të njëjtën kohë nuk ka aplikuar ndonjë system të vlerësimit dhe regjistrimit të tyre e kosnektivisht edhe të zhvlerësimit të tyre.

2.4 Asetet Financiare

Asetet Financiare klasifikohen në kategoritë e specifikuar vijuese: mjetet financiare në vlerën reale përmes fitimit apo humbjes, kreditë dhe të arkëtueshmet, mallrat e gatshmet për shitje. Klasifikimi varet nga natyra dhe qëllimi e mjeteve financiare që janë përvetsuar. Menaxhmenti e përcakton klasifikimin e mjeteve financiare në njohjen fillestare. Deri në datën e bilancit të gjendjes FBK nuk ka asete të klasifikuara në kategoritë e vlerës fer përmes Fitimit apo Humbjes aseteve të gatshme për shitje.

2.5 Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentet e parasë mbahen në bilancin e gjendjes sipas kostos. Për qëllime të pasqyrës së rrjedhës së parasë, paraja dhe ekuivalentët e parasë përfshijnë paranë në dorë dhe depozitat e mbajtura në bankë të pa afatizuara.

AT

FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS – FBK
Shënimet e Pasqyrave Financiare
Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018
Të gjitha shumat në Euro

3. Llogaritë e Arkëtueshme

Me 31 dhjetor	2019	2018
Te hyrat nga klubet	25,341	-
MKRS		
TM4	62,118	-
Projekti FIBA 3x3	3,580	-
Total	91,039	-

4. Paraja dhe ekuivalentët e saj

Me 31 dhjetor	2019	2018
TEB Bank	33,455	44,127
Paraja në arkë	130	-
Total	33,585	44,127

5. Llogaritë e Pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqesin borxhet që i ka Federata në fund te vitit 31 dhjetor 2019.

Me 31 dhjetor	2019	2018
Albtours Vas Tour Operator shpk	43,978	-
Dafi Compani Shpk	42,618	-
Emerald Hotel	19,694	-
FAME Shpk	35,821	-
Hotel International Prishtina	38,633	-
Hotel Sirius	26,304	-
Mada Group Shpk	23,799	-
Mobi Shop Mani - Nokia N.T.P.	2,144	-
NTSh Rozafa	8,779	-
Sporting	75,855	-
Taunita NPH	17,384	-
Venus Shpk	9,158	-
Tjera	25,692	-
Nën-totali	369,858	-
Starcard	827	-
Huazimet e marra	15,950	-
Total	386,635	-

A.T.

6. Pagat dhe tatimet e pagueshme

Me 31 dhjetor	2019	2018
Tatimi ne qira	89	-
Tatimi ne paga	435	-
Kontributet pensionale	681	-
Pagat e pagushme	2,302	-
Qiraja e pagushme	1,800	-
Total	5,306	-

7. Të hyrat nga aktivitetet

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor	2019	2018
Te hyrat nga kampionati evropian	196,538	-
Të tjera	48,147	18,900
Të hyrat nga aktivitetet	42,137	3,000
Komuna e Prishtines	11,000	131,222
Të hyrat nga Wild Card	-	28,942
Gjithsej të hyrat nga aktivitetet	297,822	182,064

8. Të hyrat nga aktivitetet

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor	2019	2018
Te hyrat nga kampionati evropian	196,538	-
Të tjera	48,147	18,900
Të hyrat nga aktivitetet	42,137	3,000
Komuna e Prishtines	11,000	131,222
Të hyrat nga Wild Card	-	28,942
Gjithsej të hyrat nga aktivitetet	297,822	182,064

9. Shpenzimet e Pagave

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor	2019	2018
Shpenzimet për paga e stafit të FBK	180,773	107,088
Kontributet	9,026	18,530
Gjithsej	189,799	125,618

A.E.

FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS – FBK
Shënimet e Pasqyrave Financiare

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018

Të gjitha shumat në Euro

10. Shpenzime operative

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor	2019	2018
Shpenzimet për udhëtime (Përfaqësuese dhe të tjera)	405,471	10,412
Shpenzime të tjera	170,097	34,202
Shpenzime të përfaqësueses Seniore	98,003	236,291
Ushqim për lojtarët dhe stafin e Përfaqësuesve	80,720	
Shpenzime për paisje zyrtare (logo, topa, fanella etj)	56,595	17,480
Transport	47,131	
Mirembajtje dhe rregullime të hapësirave sportive	35,147	
Marketing	30,577	
Shpenzimet për ndihmë klubeve (a)	27,017	7,000
Shpenzimet për zyre	24,744	41,241
Shërbime mjekësore	13,607	
Qiraja	11,868	
Sigurime tjera gjatë Kampionatit	9,455	
Regjistrimi i lojtareve të huaj FIBA	8,990	3,250
Telefon	8,423	
Fotograf dhe DJ	7,268	
Rryma, Uji	5,505	
Konsulencë		
	5,232	
Banese me qira për lojtarët	3,775	
Makina me qira	2,660	
Medikamente	2,509	
Sigurime Shëndetsore	1,614	
Shpenzimet për përfaqësuesëve	-	151,490
Shpenzimet për trajnime dhe seminare	-	18,766
Shpenzimet për darka zyrtare	-	2,649
Shpërblimet për Kampionët dhe më të dalluarit	-	24,000
Shpenzimet për programin TIME OUT	-	1,391
FECC	-	4,910
Gjithsej Shpenzimet Tjera	1,056,409	349,876

a) Në shpenzimet për ndihmë klubeve është e përfshirë një vlerë prej 25,270 Euro e cila është njohur si e hyrë në fund të vitit 2018 nga MKRS të cilat mjete ishin të dedikuara për KB Trepça.

Në shpenzimet operative janë të përfshira 95,475 Euro të cilat i përkasin periudhës 2018 mirëpo janë njohur si shpenzime gjatë vitit 2019 për shkak të ndryshimit të metodës së regjistrimeve të transaksioneve në kontabilitet nga baza e keshit në baza akruale. Këto shpenzime i përkasin shpenzimeve për fanella, transport, ushqim për lojtarët e tjera.

AF

FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS – FBK

Shënimet e Pasqyrave Financiare

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018

Të gjitha shumat në Euro

1. Detyrimet kontingjente dhe zotimet

Me 31 dhjetor 2019 nuk ka ndonjë detyrim kontingjent që kërkon shpalosje në pasqyrat financiare të organizatës (me 31 dhjetor 2018: zero).

Çështjet gjyqësore

Me 31 dhjetor 2019 dhe 2018, Organizata nuk ka pasur ndonjë çështje gjyqësore të hapur.

2. Ngjarjet pasuese

Nuk ka ndonjë ngjarje pas datës së raportimit që kërkon korrigjim ose shpalosje në pasqyrat financiare

ARBEN FETAHY

Arben Fetahy